ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **N.P.L. "AMBIENTI"SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **656A-23-14171-2-3-6**

Sa i përket tenderit për **Ritenderim për Mirëmbajtjen e sistemit të parkingut (garazh) te nënkalimi**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Bloomer Systems L.L.C.**
NUI	**812014710**
Adresa	**Qamil Hoxha 38/7**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**045505185**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Veton Prelvukaj**
Adresa elektronike	**info@bloomersystems.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**21.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ritenderim për Mirëmbajtjen e sistemit të parkingut (garazh) te nënkalimi

Vendimi per anulim te aktivitetit te prokurimit behet ne kudershtim me ligjin e LPP dhe se AK insiston per shperblim me kontrate OE i cili aktualisht miremabn sistemin e parkungut, gje te cilen e citon deklarativisht edhe ne mendimin e komisionit

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Procesverbali i hapjes se tendereve na eshte dorrezuar permes sistemit elektronik e-prokurimi, ne te cilen ne si OE kemi qene te pergjegjshem dhe me cmimin me te lire

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 10.04.2024 dhe me qellim te eliminim te çdo frikë ne kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit te komisionit për rivlerësim se, jemi kompani e specializuar ne ketë fushë, posedojmë autorizimin e softuerit dhe në rast se, ne shpërblehemi me kontratë assesi dhe ne asnjë rrethanë nuk do të ketë mundësi dështimi të kësaj kontrate, me ç`rast vullnetarisht kemi ofruar edhe pagesën e garancisë se ekzekutimit te tenderit edhe pse një gjë e tille nuk është kërkuar ne dosjen e tenderit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 Qëllimi (Paragrafi 1)
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca (Paragrafi 1, 2, 3 dhe 6)
- Neni 28 Specifikimet Teknike (Paragrafi 2 dhe 7)
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (Paragrafi 1,2 dhe 4)

Si dhe paragrafi 2 i nenit 38 te A01-Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti kontraktues në vazhdimësi që nga data 03.11.2023 ndërmerr veprim të cilat kanë indikacione për favorizimin e një Operatori Ekonomik, me çrast ne kemi arsyeje të besojmë se AK po ndërron kushte të caktuara me qëllim të përshtatjes së kushteve dhe specifikave teknike për te favorizuar vetëm OE e cila eshte aktualisht duke e mirëmbajtur sistemin e Parkingut.

1. AK me datën 03.11.2023 e publikon Njoftimin për kontrate, te cilin me pas e anulon me datën nëpërmjet 16.11.2023 me arsyetimin se, OE nuk i ka plotësuar kushtet për pjesëmarrje sepse nuk janë dorëzuar katalogu i produkteve dhe certifikata CE e pajisjeve. Me ç`rast oferton vetëm një operatore ekonomik.

2. AK me datën 04.12.2023 e publikon Ri-tenderim Njoftimin për kontrate, kësaj radhe duke i eliminuar kërkesat nga njoftimi paraprak te cilat përsëri OE nuk kishte arrit te përmbush ne ofertimin paraprak. Edhe ky njoftim anulohet me vendimin e datës 08.12.2023 me arsyetimin se, OE ka bere gabim ne llogaritjen e çmimit.
Ne kemi arsyeje te besojmë se, AK me qellim te favorizimin ne procedurën e ri-tenderimit i ka ndryshuar dëshmitë e dokumentuara për kërkesat e përshtatshmërisë, Katalogu i pajisjeve dhe certifikata CE me qellim te përshtatjes së kushteve. Me ç`rast oferton vetëm një operatore ekonomik

3. AK me datën 21.12.2023 e publikon njoftimin e radhës për Ri-tenderim Njoftimin për kontrate. Me ç`rast ofertojnë dy operatore ekonomik.
Me datën 29.12.2023 AK nëpërmjet letrës standarde dërgon kërkesën për sqarim.

Nëpërmjet kësaj kërkese AK përveç se parashtron kërkesa te cilat nuk kane qene pjese e dosjes se tenderit por edhe ushtron favorizim ne raport me Operatoret e tjerë me kundërshtim me Nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (Paragrafi 1,2 dhe 4) dhe paragrafi 2 i nenit 38 te A01-Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Me qellim te sqarimit sa me kronologjik ne me datën 04.01.2024 ne cilësinë e AK ju kemi kthye përgjigje AK-se duke ri potencuar se si kompani e specializuar në fushën e instalimit, montimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të parkingut, kemi lexuar me kujdes dosjen e tenderit kemi ofruar dëshmi të dokumentuara për kërkesat e përshtatshmërisë dhe duke ja kujtuar AK-se, se me kërkesën pre sqarim favorizon direkt një OE dhe na diskriminon neve si dhe përben shkele te neneve si me poshtë:
- Neni 1 Qëllimi (Paragrafi 1)
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca (Paragrafi 1, 2, 3 dhe 6)
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (Paragrafi 1,2 dhe 4)
Si dhe paragrafi 2 i nenit 38 te A01-Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

5. Me datën 05.01.2024 AK ne nxjerre vendim per shpërblim me kontrate operatorin ekonomik me çmimin me te lartë edhe përkundër faktit se, një OE tjetër ka oferte me te lire dhe i plotëson te gjitha kushtet e parapara ne tender.

6. Me datën 10.01.2024 në cilësinë e palës së interesuar ne kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues duke paralajmërur se do te shkelen dispozitat e LPPK dhe A01-Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik duke bashkangjitur edhe prova te mjaftueshme për dispozitat e shkelura te LPP-së. si ne vijim:
- Neni 1 Qëllimi (Paragrafi 1)
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca (Paragrafi 1, 2, 3 dhe 6)
- Neni 28 Specifikimet Teknike (Paragrafi 2 dhe 7)
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (Paragrafi 1,2 dhe 4)

7. Me datën 12.01.2024 AK ne ora 09:11 nxjerr vendim mbi pezullimin e aktivitetit.

8. Po me datën 12.01.2024 AK ne ora 14:01 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetim, qe ne kemi arsyeje te besojmë se favorizon nje OE te vetem duke na diskriminuar neve. Për me tepër, arsyeja e refuzimit te kërkesës tonë për rishqyrtim ne vete shpërfaqë favorizimin ndaj një OE citim i zyrtares se prokurimit -Ne nga dosja e tenderit, nenkuprojme se sistemi i parkingut ekziston" dhe vazhdon citimi ne paragrafin e radhës " Emrin e prodhuesit te sistemit i cili është duke funksionuar momentalisht, nuk e

kemi përmendur apo cekur për arsye se kemi patur parasysh parasysh nenin 7 barazia ne trajtim/ Jo diskriminimi ligji Nr.04/L-042 i LPPK” duke respektuar ligjin vetëm deklarativisht e veprimet i ka marrë ne kundërshtim me ligjin te cilin vet e citon.

9. Me datën 22.01.2024 në cilësinë e palës së interesuar ne kemi ushtruar ankese ne OSHP kundër vendimit te AK duke argumentuar dëshmi e fakte te cilat i konsiderojmë se përbejnë favorizimin e njërës pale përkatësisht, diskriminimin e palës tjetër. Ankesa pran OSHP-se është evidentuar me numër protokolli 0062/2024.

10. Me datën 02.02.2024 eksperti shqyrtues nxjerre raportin e ekspertit duke i vlerësuar pretendimet tona si te bazuara dhe duke i rekomanduar panelit shqyrtues te OSHP-se:
- Ankesa e OE te aprovohet si e bazuar
- Te Anulohet njoftimi për dhenje te kontratës, dhe
- Lënda te kthehet ne rivlerësim

11. Me datën 15.02.2024 përderisa ankesa jone ishte ne fazën e trajtimit nga paneli i OSHP, Autoriteti Kontraktues pa mbështetje ligjore nxjerre vendim mbi formimin e komisionit te ri për rivlerësimin e tenderit.

12. Me datën 03.02.2024 në cilësinë e palës së interesuar ne si OE jemi pajtuar me raportin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

13. Me datën 21.02.2024 OSHP nxjerre vendimin me Nr. OSHP:2024/0062 nga i cili kemi kuptuar se, edhe AK pajtohet me raportin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues. Ne vendimin e OSHP-se, precizohen se, ne pajtim me nenin 19, paragrafi 4, të Rregullores për punën e OSHP, parashihet se, cituar: “Në rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerrë njoftim që autoriteti kontraktues në afat prej 5 ditësh ta implementoj raportin ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedurë

14. Me datën 15.03.2024 përtej çdo afati dhe duke mos respektuar vendimin e OSHP-se AK parashtron kërkesë për zgjatje te afatit te validitetit te ofertës për 60 ditë gjë te cilën ne edhe e kemi ber.

15. Me datën 05.04.2024 AK publikon raportin e komisionit rivlerësues. Komisioni nuk përqendrohet ne rivlerësimin e ofertave sipas mandatit te vet dhe ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit por rekomandon anulimin e tenderit. Komisioni nëpërmjet raportit rekomandon anulimin e procedurës me dy arsyeje:
- Atyre ju nevojitet vetëm mirëmbajtja e sistemit nga operatori aktual, pra qëllimi i favorizimit shpërfaqet edhe nga komisioni rivlerësues.

- Nuk kane mundësi buxhetore qe ta beje ndërrimin e sistemit, dhe,
- Nëse e merr sistemi ne menaxhim ndonjë operatorë tjetër si rrjedhoje e kësaj një kontrate e tille nuk mund te ekzekutohet (e monopolizon sistemin ne një OE te vetëm).

16. Me datën 05.04.2024 AK nxjerre vendim mbi anulimin e procedurës se prokurimit duke u mbështetur ne ne ligjin 04/L-042 neni 63 pika 1.1

17. Me datën 10.04.2024 dhe me qellim te eliminim te çdo frikë ne kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit te komisionit për rivlerësim se, jemi kompani e specializuar ne ketë fushë, posedojmë autorizimin e softuerit dhe në rast se, ne shpërblehemi me kontratë assesi dhe ne asnjë rrethanë nuk do të ketë mundësi dështimi të kësaj kontrate, me ç`rast vullnetarisht kemi ofruar edhe pagesën e garancisë se ekzekutimit te tenderit edhe pse një gjë e tille nuk është kërkuar ne dosjen e tenderit.

18. Me datën 11.04.2024 AK nxjerre vendim mbi pezullimin e aktivitetit.

19. Me datën 12.04.2024 AK nxjerre vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duke u mbështetur ne konstatimet e raportit te komisionit për rivlerësim te datës 05.04.2024 me arsyetimin "forma e incimit te kësaj procedure nuk përkon me gjendjen te sistemit aktual te parkingut dhe si pasoje një kontrate e tille nuk do te mund te zbatohet apo gjate ekzekutimit do te ketë pengesa për arsyeje se, sistemi i parkingut është i trashëguar nga komuna e Ferizajt

20. Refuzimi i serishëm i kërkesës tone për rishqyrtim na bene edhe me shume te besojmë se, e gjithë kjo procedure e ka vetëm një qellim, favorizimin ndaj një operatori ekonomik sepse është jashtë çdo logjike te shfaqet frika e dështimit te kontratës vetëm e vetëm se kontratën nuk do ta fitoj operatori i preferuar/aktual.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Angazhimi i personelit shtese

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*